



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVE

Nr. 15109 Prot

Vlorë, më 22.08 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR AKSESIN NË OBJEKTIN E PROPOZUAR NGA AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT NDODHUR NË ZK 3140, PASURIA ME NR. 252, ME SIPËRFAQE 116 M2, NDODHUR NË ORIKUM VLORE”

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 261 - 292 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Nenit 34 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Shkresën nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me nr. 564/7 prot. datë 01.07.2026 drejtuar Bashkisë Vlorë, Urdhërin e Brendshëm nr. 1280, datë 24.08.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 1564/7 prot datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konfirmimin e aksesit në objektin e propozuar”, shkresës nr. 17082 prot. datë 21.08.2026 drejtuar Njesisë Administrative Orikum:

VENDOSI:

- 1.Dhënie e dakortësisë për aksesin në objektin e propozuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit ndodhur në ZK 3140, pasuria me nr. 252, vol. 4, faqe 215, për sipërfaqen 116 m2, ndodhur në Orikum Vlorë.
- 2.Ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Urbanistikës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Konceptoi: A. Plepi

Drejtorja e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve:

B. Bisholla

Drejtorja e Urbanistikës:

Ingli Xhaferaj

Drejtorja Juridike:

Mirela Mishgjoni

ME URDHËR DELEGIMI

NËNKRYETAR

Edmond Begiri

KRYETAR
Brunilda Mersini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 19108 Prot

Vlorë, më 22.07 2026

R E L A C I O N

**“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR AKSESIN NË OBJEKTIN E PROPOZUAR NGA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT NDODHUR NË ZK 3140, PASURIA ME
NR. 252, ORIKUM VLORE”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 261 - 292 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Nenit 34 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Shkresën nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me nr. 564/7 prot. datë 01.07.2026 drejtuar Bashkisë Vlorë, Urdhërin e Brendshëm nr. 1280, datë 24.08.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 564/7 prot datë 24.08.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konfirmimin e aksesit në objektin e propozuar”, shkresës nr. 17082 prot. datë 21.08.2026 drejtuar Njesisë Administrative Orikum:

Objekti i këtij relacioni është dhënia e dakortësisë për aksesin në objektin e propozuar nga agjencia e zhvillimit të territorit ndodhur në zk 3104, pasuria me nr. 252, Orikum Vlorë, marrë shkak nga shkresa me nr. 564/7 prot, datë 01.07.2026 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, me objekt Leje Ndërtimi për ndërtimin e objektit “ Kompleks rezidencial me shtëpi të dyta “The Collection” me 1,2,3,4 dhe 5 kate, me vendndodhje Orikum, Bashkia Vlorë dhe subjekt ndërtues “3S” sh.p.k.

Pasuria me nr.252 e llojit “rrugë+kanal”, e ndodhur në zonën kadastrale 3140, me sipërfaqe 6400 m2, është në inventarin paraprak të Njesisë Administrative Orikum referuar edhe shkresës me nr. 1300/1 prot datë 26.08.2026 të Njesisë Administrative Orikum, ku bashkëlidhur është edhe fleta e inventarit paraprak.

Me qëllim trajtimin e kërkesës së AZHT , gjithashtu u ngrit dhe urdhëri i brendshëm me nr.1280, datë 24.08.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr.564/7, datë 01.07.2026, të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për konfirmim të aksesit në objektin e propozuar”, si dhe u mbajt dhe akt-konstatimi me nr.17145/1 prot, datë 21.09.2026 nga ku u evidentua në terren se sipërfaqja që do të përdoret nga Shoqëria 3S është 116 m2, e ndarë në 3 segmente. Segmenti 1, me orientim veri – jug me sip. 45 m2, segmenti 2 me sip. 36 m2, segmenti 3 me sip 35 m2. Pjesa takuese e kësaj pasurie që kufizohet me pasuritë e sipërpërmendura duke u matur grafikisht në rilevimin topografik është me në total 116 m2 nga sipërfaqja totale prej 6400 m2 ku figuron gjurma e kanalit.

Nga grupi i punës u konstatua se si rezultat i punimeve të kryera nga ndërtimi i rrugës, gjurma e këtij kanali nuk duket dhe nuk është e dallueshme, pasi ka bimësi të ndryshme të cilat pengojnë shikueshmërinë e kanalit, ku bashkëlidhur janë edhe fotot nga terreni. Grupi i punës ka hartuar plan rilevimi për pozicionimin e pasurisë me nr.252 të llojit kanal, për sip. 116 m2, do të jepet pëlqimi për akses sipas hartës topografike në shkallën 1: 500 që shoqëron shkresën e AZHT-së.

Në bazë të nenit 34, pika 2.1 e Ligjit nr. Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar ku citohet se:

2.1Për pronat shtetërore apo publike, të cilat figurojnë në përgjegjësi administrimi të institucioneve publike, servituti i kalimit jepet nga KKTU-ja së bashku me lejen e zhvillimit apo të ndërtimit, pas marrjes së dakordësisë nga institucioni përkatës.

Duke shprehur dakortësinë, ky akses mund të revokohet në të gjitha rastet nëse Shoqëria “Aulona Konstruksion”:

1. Pengon infrastrukturën e kullimit duke prishur parametrat e kalimit kullues si pjerësia, prerja tërthore dhe funksionaliteti i tij.
 2. Nëse kjo pasuri bëhet pjesë e një projekti publik.
 3. Nëse bëhet pjesë e konfliktit me palë të treta.
 4. Nëse nuk krijon akses për pastrimin e këtij kanali, me pika kontrolli.
- Bashkëlidhur relacionit janë bashkëlidhur dokumentacionet e vendosura në dispozicion nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, grupi i punës, Njësia Administrative Orikum.

1- Shkresa me nr. 564/7 prot, datë 01.07.2026 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit

2-Urdhërin e Brendshëm nr. 1280, datë 24.08.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 564/7 prot datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konfirmimin e aksesit në objektin e propozuar”.

3-Akt konstatimi me nr. 17145/1 datë 21.09.2026

4- Shkresa nr. 472/1 prot. Datë 28.04.2026 kthim përgjigje Njësia Administrative Orikum.

5- Shkresë nr. 1300/1 prot. Datë 26.08.2026 drejtuar Njesisë Administrative Orikum.

6- Shkresa nr. 16910/1 prot. drejtuar Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Sektorit të Bordit të Kullimit.

7- Kthim përgjigje e Sektorit të Bordit të Kullimit nr. 930/1 prot. Datë 21.09.2026.

Për sa më lartë vendimmarrja juaj për këtë vendim, merret sipas Neni 54, pika e/1 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ju faleminderit!

Konceptoi: A. Plepi

Grupi punës: Aiken Hoxha

Bardhyl Shytaj

Seldi Dalipaj

DREJTOR
Bruna Bisholla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 17145/ prot

Vlorë, më 21.09.2026

AKT -KONSTATIMI

I mbajtur sot më datë 08.09.2026, në Radhimë Vlorë, ZK 3140 në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr.1280, datë 24.08.2026, të Kryetares së Bashkisë Vlorë, "Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës Nr.564/7 Prot, datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit "Për konfirmim të aksesit në objektin e propozuar "Objekt rezidencial me shtëpi të dyta "The Collection " me 1,2,3,4 dhe 5 kate mbi tokë, me një kat parkim nën tokë " me vendndodhje Orikum Vlorë."

Ky urdhër është ngritur bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore ", neni 8 , Neni 9.1, pika 1.1/a dhe b Neni 23, pika 9 , Neni 64 pika "a" dhe "gj" , Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.31, datë 29.04.2025 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, Qarku Vlorë", Udhëzimin Nr.1, datë 06.05.2016, Udhëzimin Nr.24 , datë 07.12.2016, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" , Ligjin Nr. 107/2014 " Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", si dhe në kërkesën Nr. 564/7 Prot, datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Bashkisë Vlorë.

Në zbatim të këtij Urdhëri dhe kërkesës së AZHT-së , grupi i punës më datë 08.09.2026 ka kryer verifikimin në terren në pasurinë objekt i këtij urdhëri dhe është konstatuar se në Zonën Kadastrale Nr. 3140, Orikum - Vlorë ndodhet rrugë ekzistuese + kanali me Nr.252 Pasurie , i cili pasqyrohet në hartën treguese të regjistrimit (HTR).

Sipërfaqja që do të përdoret nga "Shoqëria 3S SH.P.K" është 116 m2, (i ndarë në 3 segmente) segmenti 1, orientimi veri - jug 45, m2, segmenti 2 me sipërfaqe 36 m2, segmenti 3 me sip 35 m2 , sipas planimetrisë së lejes së ndërtimit miratuar nga AZHT ku është e përcaktuar me shigjetë të zezë, segmentet që kërkohet akses në sheshin e ndërtimit.

Gjithashtu u konstatua se si rezultat i punimeve të kryera nga ndërtimi i rrugës, gjurma e këtij kanali nuk duket dhe nuk është e dallueshme, pasi ka bimësi të ndryshme të cilat e pengojnë shikueshmërinë e kanalit. (bashklidhur foto të konstatimit në terren)

Për sa më sipër grupi i punës, ka hartuar plan rilevimi për pozicionimin e pasurisë me Nr.252, të llojit kanal ku për sipërfaqen prej 90,9 m² do të jepet pëlqimi për akses sipas hartës topografike në shkallën 1: 500 që shoqëron shkresën e AZHT- së .

GRUPI I PUNËS


Seldi Dalipaj



Bardhyl Shytaj




Aiken Hoxha
















SUBJEKTI "3S" SH.P.K.




SIPËRFAQE E KANALIT NR.PASURIE 252 = 58 M²



SIPËRFAQE E RRUGËS EKZISTUESE NR.PASURIE 252 = 58 M²

SIPËRFAQE TOTALE = 116 M²



HARTA KADASTRALE SHKALLA 1:1000



ORTOFOTO SHKALLA 1:1000

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA PËR ZHVILLIMET NË TERRITOR

Nr. 564/7 Prot.

Tiranë, më 01/072026

Lënda: Kërkesë për miratim/dakordësi.

BASHKISË VLORE

Për dijeni:

SHOQËRISË "3 S" SH.P.K

Adresa: Rr. "Vlorë-Orikum", Km 25, Lgj. "Radhimë", Kompleksi Ansi, Cel: 0682870482

VLORE

Të nderuar,

Pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, aplikimi, protokolluar pranë AZHT me Nr. 3034 Prot, datë 10.07.2024 për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Kompleks rezidencial me shtëpi të dyta "The Collection" me 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë, me 1 kat parkim nëntokë", me vendndodhje në Orikum, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "3S" sh.p.k.

Në vijim të korrespondencës në lidhje me projekt propozimin sipërcituar, si dhe referuar plotësimit të dokumentacionit datë 30.06.2026 me anë të së cilës subjekti zhvillues ka vendosur në dispozicionin tonë projektin në të cilin ka paraqitur grafikisht zgjidhjen teknike për aksesin në pronë e cila kryhet nëpërmjet pasurisë me nr. 252/ Volum 4, Faqe 215, Zk 3140 e llojit "Rrugë + Kanal" me sipërfaqe 6400 m² në pronësi Shtet, konfirmuar nga DV ASHK Vlorë nëpërmjet sistemit e-leje, datë 24.06.2026.

Për sa më sipër, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, në përputhje me VKM-në 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar dhe Urdhrin Nr. 143, datë 03.11.2015 të Kryeministrit "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për bashkërendimin e punës me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT)", për përmbushjen e detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e zhvillimit të territorit, kërkojmë informacion mbi gjendjen faktike në terren të pasurisë nëse është e llojit "Rrugë" apo "Kanal"

si dhe lutemi për miratimi tuaj në lidhje me projekt propozimin sipërcituar referuar zgjidhjes teknike të propozuar nga subjekti zhvillues për aksesin në pronë nëpërmjet pasurisë me nr. 252/ Volum 4, Faqe 21, Zk 3140.

Bashkëlidhur do të gjeni:

- Shkresën e DV ASHK Vlorë datë 24.06.2026 shoqëruar me projektin për zgjidhjen teknike mbi pasurinë me nr. 252/ Volum 4, Faqe 21, Zk 3140.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Adelajda Roka

Konceptoi: E. Hazizi, Specialist, Drejtoria Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve
L. Shazivari, Specialist, Drejtoria e Zhvillimit në Territor
Miratoi: A. Basha, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve
S. Kushi, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit në Territor

PROJEKTI
RESORT REZIDENCIAL DHE TURISTIK
"THE COLLECTION" 1, 2, 3, 4 DHE 5
KATE MBI TOKE, ME 1 KAT NENTOKE,
ME VENDRRODJEJE ME ORGJUM,
BASHKIA VLORE, ME ZHVILLUES
SHOQERINE "3 S" SH.P.K.


ARHITEKTURA
JA Joubert Architecture

L. 8/1/2011 Nr. Licenca N. 7331
SIDRIT FOTI PRIFTI Nr. Licenca A-134092


FAZA E PROJEKTE
LEJE NDERTIMI

PROJEKTI ARKITEKTONIK

LIMI I PLETES:
PLANI I SISTEMIMIT
POS8



A03



PROJEKTI:
RESORT REZIDENCIAL DHE TURISTIK
"THE COLLECTION" 1, 2, 3, 4 DHE 5
KATE MBI TOKË, ME 1 KAT NËNTOKË,
ME VENDNDODHJE NË ORIKUM,
BASHKIA VLORE, ME ZHVILLUES
SHOQËRINË "3 S" SH.P.K.

ARKITEKTURA:
JA Joubert Architecture

UNIS Architects
SIDRIT FOTI PRIFTI
Nr. Licence N.7337
Nr. Licence A.1849/2

FAZA E PROJEKTTI:
LEJE NDËRTIMI

PROJEKTI ARKITEKTONIK

EMRI I FLETËS:
PLANI I KATIT TË PARË NËNTOKË -
KUOTA -3.50

P058

SHENIME:
NË KËTË FLETË ESHTË PARAQITUR PLANI I KATIT TË
PARË NËNTOKË, KUOTA -3.50, REFERUAR KUOTËS
+0.000 TË OBJEKTIT.

* 311 VENDE PARKIMI



A04

SHKALLA: 1:750

DATA: 13/11/2025



Outlook

email +
ch if ✓

Shkresë përcjellëse, Bashkia Vlore

From Info eleje <Info.eleje@azht.gov.al>

Date Wed 8/12/2026 3:02 PM

To Info Bashkia Vlore <info@vlora.gov.al>

Cc Ingli Xhaferaj <ingli.xhaferaj@vlora.gov.al>

Ingli

6 attachments (12 MB)

2026-06-30_P058_The-Collection_Parkimi.pdf; 2026-06-30_P058_The-Collection_Pl.Sistemimi.pdf; 2026-06-30_P058_The-Collection_PLV_LN.pdf; 2026-06-30_P058_The-Collection_Top-View.pdf; Signed2008639202606251841589121_destination.pdf; BASHKIA VLORE, 3S 564-7.pdf;

Përshëndetje,

Po Ju përcjellim këtu bashkëlidhur, shkresën përcjellë Bashkisë Vlorë dhe dokumentat shoqëruar kësaj shkrese të përcjellë në format CD, gjithashtu shkresën e Drejtorisë Vendore ASHK Vlorë.

Me respekt,

Grupi i Punës E-leje

Drejtoria e Koordinimit Ndërinstitucional dhe NJ.V.V.-ve

Agjencia e Zhvillimit të Territorit

*Adresa: Rr. "Themistokli Gërmenji", Pallati Frashëri, Kati 2
Tiranë, Shqipëri.*



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 17145 prot.

Vlorë, më 24.08 2026

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 1280 datë 24.08 2026

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR TRAJTIMIN E KËRKESËS NR.
564/7 PROT. DATË 01.07.2026 TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT PËR KONFIRMIM TË AKSESIT NË OBJEKTIN E PROPOZUAR”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, Neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, Neni 23, pika 9, Neni 64 pika a dhe gj, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31, datë 29.04.2025 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorë”; në Udhëzimin nr.1 datë 06.05.2016 dhe Udhëzimin nr.24 datë 07.12.2016) “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe në Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, si dhe në kërkesën nr. 564/1 prot. datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Bashkisë Vlorë.

URDHËROJ:

1. Të ngrihet grupi i punës për verifikimin në terren të pasurisë nr. 252, faqe 215, ndodhur në ZK 3140, vol. 4, e llojit “Rrugë+Kanal”, me sipërfaqe 6400 m², në pronësi shtet ndodhur në Vlorë, i përbërë nga anëtarët si më poshtë:

- Bardhyl Shytaj, Topograf DPPMA
- Aiken Hoxha, Topograf DPPMA
- Seldi Dalipaj, Jurist DPPMA

2. Grupi i punës sipas pikës 1, duhet të verifikojë në terren pasurinë e llojit rrugë + kanal në pronësi “shtet”, të mbaj akt konstatimi, të pasqyrojë në plan rievimi situatën faktike të

pronës, si dhe të përcaktojë sipërfaqen në m2 që do të përdoret për aksesin në objektin e propozuar nga AZHT.

4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen personat sipas pikës 1 të Urdhërit, si dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.


Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

KRYETAR
Brunilda Mersini

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKE SHQIPËRISE" and "BASHKËMIRE" around the perimeter, with a central emblem. The signature is written in a cursive, flowing style.

8/17/26, 4:46 PM

Inbox - Bruna Bisholla - Outlook



35

16810

19.08.2026

Fw: Shkresë përcjellëse, Bashkia Vlore

From Ingli Xhaferaj <ingli.xhaferaj@vlora.gov.al>

Date Mon 8/17/2026 2:34 PM

To Bruna Bisholla <Bruna.Bisholla@vlora.gov.al>

6 attachments (12 MB)

2026-06-30_P058_The-Collection_Parkimi.pdf; 2026-06-30_P058_The-Collection_Pl.Sistemimi.pdf; 2026-06-30_P058_The-Collection_PLV_LN.pdf; 2026-06-30_P058_The-Collection_Top-View.pdf; Signed2008639202606251841589121_destination.pdf; BASHKIA VLORE, 3S 564-7.pdf;

Get [Outlook for iOS](#)

From: Info Bashkia Vlore <info@vlora.gov.al>

Sent: Monday, 17 August 2026 12:38:42

To: Ingli Xhaferaj <ingli.xhaferaj@vlora.gov.al>

Subject: Fw: Shkresë përcjellëse, Bashkia Vlore

Bashkia Vlorë

Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë, 9400, Shqipëri



BASHKIA VLORE

From: Info eleje <Info.eleje@azht.gov.al>

Sent: Wednesday, August 12, 2026 3:02 PM

To: Info Bashkia Vlore <info@vlora.gov.al>

Cc: Ingli Xhaferaj <ingli.xhaferaj@vlora.gov.al>

Subject: Shkresë përcjellëse, Bashkia Vlore

Përshëndetje,

Po Ju përcjellim këtu bashkëlidhur, shkresën përcjellë Bashkisë Vlorë dhe dokumentat shoqëruar kësaj shkrese të përcjellë në format CD, gjithashtu shkresën e Drejtorisë Vendore ASHK Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

DREJTORIA VENDORE VLORE

Nr _____ Prot

Date _____

Lënda : KTHIM PERGJIGJE

Drejtuar AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Ne pergjigje te aplikimit tuaj 24387 date 04/06/2026 ku keni aplikuar sherbimin "Informacion Zyrtar per persona dhe pasuri te paluajtshme" ku kerkoni kufitare ne jug per pasurine 519/30/4 dhe ne lindje per pasurine 519/18 ne zk 3140 pas verifikimit hartografit te kryer rezulton se te dyja pasurite e sipercituara kane kufitar te perbashket pasurine me nr 252/ Volum 4 Faqe 215 Zk 3140 e cila eshte e llojit Rruge + Kanal me siperfaqe 6400 m2 ne pronesi "Shtet".

Faleminderit për bashkëpunimin,

DREJTOR

ALBION KOCI

Stiven
Cobani

Digitally signed by:
Stiven Cobani
Date: 2026.06.24
04:25:59 +02'00'

Albion
Koci

Digitally signed by:
Albion Koci
Date: 2026.06.25
06:41:58 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2026/06/24 16:26:06 +02'00'
L52205454A2026062416255951014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 17082 prot.

Vlorë, më 21.08 2026

Lënda : Kërkesë për informacion

NJËSISË ADMINISTRATIVE ORIKUM

Bulevardi "Princesha Rugjinë", Orikum

Me qëllim trajtimin e kërkesës nr. 2958/4 prot. datë 29.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Bashkisë Vlorë për konfirmim të aksesit në pasurinë nr. 363, ZK 3140, sip. 1500 m2, vol. 4, F 125, ndodhur në Radhimë, Vlorë si dhe shkresës nr. 564/1 prot. datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Bashkisë Vlorë për konfirmim të aksesit në pasurinë nr. 252, faqe 215, ndodhur në ZK 3140, vol. 4, e llojit "Rrugë+Kanal", me sipërfaqe 6400 m2, ndodhur në Orikum, Vlorë kërkojmë:

Konfirmim nëse pronat e sipërpërmendura të llojit "kanal" janë në inventarin paraprak të pronave të Njesisë Administrative Orikum.

Informacioni i kërkuar të përcillet sa më shpejt, me qëllim trajtimin e kërkesës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion shresat e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit:

- Shkresën nr. 2958/4 Prot. datë 29.06.2026
- Shkresën nr. 564/1 Prot. datë 01.07.2026

Duke Ju falenderuar!

DREJTOR
Bruna Bisholla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

Nr. 1300/1 prot.

Vlorë, më 26 . 08 2026


Lënda: Përgjigjie kërkesë për informacion

Drejtoria Pronave Publike Menaxhimit të Aseteve
Bashkia Vlore

Në përgjigjie Suajës të datës 21.08.2026, me nr.17082prot., protokolluar pranë Njesisë Administrative Orikum më datën 24.08.2026, me nr.1300prot., ku kërkonti t'ju konfirmojmë që prona e llojit "kanal", me numër pasurie 252 e ndodhur në zonën kadastrale 3140, me sipërfaqe 6400m², nëse është në inventarin paraprak të Njesisë Administrative Orikum, ju shprehemi si më poshtë:
Pasuria me nr.252 e ndodhur në ZK.3140 me sipërfaqe 6400m², e llojit "kanal" është në inventarin paraprak të Njesisë Administrative Orikum.

ADMINISTRATOR

Drini Harizaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE ✓

Nr. 16 P/10 / prot.

Vlorë, më 16.09 2026

Lënda: Mbi informacionin për kanalin kullues .

**NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORIT TË BORDIT TË KULLIMIT**

Në bazë të urdhërit të brendshëm të punës nr. 1233 datë 14,08,2026 prot.16682 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr . 2958 prot .datë 29,06,2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për konfirmim të aksesit në objektin e propozuar” .

Kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse kanalet kullues me nr.363 pasurie dhe nr . 252 pasurie Zk .3140 të ndodhura në Radhimë janë pjesë e sistemit kullues të administruar / mirëmbajtur nga ana juaj dhe nëse janë funksional.

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju vendosim në dispozicion shkresat e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Duke ju falënderuar!

DREJTOR

Bruna Bisholla



16910/2
22.03.2026

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VLORE

NDERMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr 930/1 Prot

Vlorë, më 21.09.2026

Lënda: Informacion për kanalet kulluese.

DREJTORISË SË PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVE
BASHKIA VLORE

Në përgjigje së suajës nr.16910/1 Prot., date 16.09.2026 hyrë në institucion nr.930 Prot., date 21.09.2026, ku kërkon informacion nëse kanalet kulluese me Nr. 363 Pasurie dhe Nr. 252 Pasurie Zk 3141 të ndodhura në Radhimë ku janë pjesë e sistemit kullues të administruar mirëmbajtur nga ana jonë dhe nëse janë funksional, ju sqarojmë si më poshtë:

Sipas VKM-së Nr. 1108 datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", ka transferuar gjithë asetet e tij pranë Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Vlorë.

Bashkitë bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për planifikimi e nevojave për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit.

Kanalet kulluese të ndodhura në Zk 3140 në Radhimë me Nr.363 Pasurie dhe Nr.252 Pasurie janë pjesë e inventarit paraprak të Njesisë Administrative Orikum, Bashkia Vlorë.

Nga sa më sipër kanalet me Nr.363 Pasurie dhe Nr.252 Pasurie, të ndodhura në Radhimë janë pjesë e mirëmbajtjes nga Sektori I Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Vlorë.

DREJTOR

